



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

Mbledhja nr. 20/2008

Më 02.10. 2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla C-203

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani, Et'hem Çeku, Haki Shatri, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj, Safete Hadergjonaj, Zef Morina dhe Sala Berisha – Shala.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Mufëra Şinik.

Të pranishëm: Gani Koci - kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Xhevdet Smakiqi - këshilltar i ministrit të MTPT, Mevludin Krasniqi - këshilltar i ministrit të MTPT, Remzije Hajdari – Departamenti Ligjor në MTI, Bujar Kuqi - Departamenti i Turizmit, Hysen Sogojeva - shef i Divizionit të Hotelerisë në MTI, Artan Canhasi dhe Lejla Selmi nga OSBE-ja, Haxhi Gashi nga USAID-i, Lumnije Berisha nga Kryesia, Blerina Uka nga NDI-i, Valmir Ismajli dhe Valon Hyseni nga KDI-ia.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nurije Morina.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së kaluar të 16 shtatorit 2008;
3. Shqyrtimi i Ligjit: a) për shpronësim; b) për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rrugët nr. 2003/11 dhe c) për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrik 2008);
4. Miratimi i listës së kandidatëve për Komisionin e konkurrencës;
5. Të ndryshme;

**Safete Hadergjonaj** – “Nuk e kuptoj stafin e administratës, nuk po di apo nuk po do me e përgatitë mirë raportin për Projektligjin për ndryshim plotësimin e ligjit për NVM. Ne mbledhjen e fundit kam dhënë vërejtje për raportin dhe kam shpreh gatishtësinë për të punuar me stafin e administratës për të rregulluar ashtu që të mos përcillen gabimet edhe me tutje. Stafi prapë e ka përgatitë raportin pa u konsultuar dhe prapë me gabime e ka përcjell në KBF. Nuk i ka përfshi propozimet që i kam dhënë, që neni 4 të përcillet në amendamentin 6 pas nenit 5, është ndryshuar amendamenti që kam propozuar që ka të bëjë me nenin 5 të projektligjit, si dhe nuk janë përmirësuar referencat. Deshta të ju njoftoi që në KBF është miratuar ky raport pasi nuk ka implikime buxhetore por komisioni kërkon nga Njësia për standardizim dhe harmonizim ligjor të rregulloj referencat e projektligjit në bazë të teknikës së hartimit të amendamenteve.”

**Vërejtje:** ky koment është i perpiluar nga vetë znj.Hadergjonaj, si vërjetje në mbledhjen e datës 14.10.2008;

### **I. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të 16 shtatorit 2008;**

Procesverbali i mbledhjes së 16 shtatorit 2008 u miratua pa vërejtje.

### **III. Shqyrtimi i Ligjit: a) nr. 02/L-97 për shpronësim; b) nr. 02/L-35 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rrugët nr. 2003/11 dhe c) nr. 03/L-027 për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);**

**Kryetarja** – propozoi që këto pika të shtjellohen veç e veç, duke filluar nga pika e parë për Ligjin për shpronësimin sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008.

### **III/a) Ligji nr. 02/L-97 për shpronësim (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);**

**Kryetarja** – ua dha fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Transportit dhe të Postelekomunikacionit (më tutje: MTPT), për t'i paraqitur vërjetjet e tyre.

**Xhevdet Smakiqi - këshilltar i ministrit të MTPT-së** – para Komisionit i paraqiti vërjetjet e tyre në formë propozimi për Ligjin për shpronësim, gjegjësisht në nenin 2, në neni 13 paragrafi 2, në nenin 14 paragrafi 1 pika a) dhe në nenin 14 paragrafi 1 pika e).

**Gani Koci - kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa** – diskutimin e tij e përqendroi në sqarimin e këtyre vërejtjeve të propozuara nga ana e MTPT-së, duke kërkuar prej tyre shtjellim më të thuktë. Po ashtu propozoi të merren edhe mendimet e ministrive të tjera, në të cilat aludohet se shpronësimi mund ta përfshijë fushën e tyre të kompetencës.

Pas diskutimeve të deputetëve Et'hem Çeku, Berim Ramosaj, Zef Morina, Safete Hadergjona dhe Haxhi Gashi nga USAID-i, Komisioni e nxori këtë:

### **Përfundim**

- a) Shtyhet - vazhdohet rishqyrtimi i Ligjit për shpronësim, me qëllim të mbledhjes së informatave;
- b) Autorizohen të interesuarit që brenda afatit të propozojnë dhe të arsyetojnë amendamente përkatëse;
- c) Autorizohet administrata që ta bëjë harmonizimin e preambulës dhe të dispozitës së hyrjes në fuqi të Ligjit, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

### **III/b) Ligji nr. 02/L-35 për ndryshim dhe plotësim e Ligjit për rrugët nr. 2003/11 (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);**

**Kryetarja** – e hapi diskutimin edhe për këtë nënpikë të rendit të ditës dhe kërkoi komente të anëtarve të Komisionit.

**Zef Morina** – theksoj se ky ligj ka nevoj për amendamentim, andaj propozoi që të shtyhet rishqyrtimi për mbledhjen e radhës në të cilën do t'i paraqesë vërejtjet e veta.

**Kaqusha Jashari** – i paraqiti disa vërejtje. Tha se nëse vazhdohet shqyrtimi i Ligjit edhe më tej, ajo do t'i paraqes më shkrim disa amendamente së bashku me arsyetimin.

**Xhevdet Smakiqi - këshilltar i ministrit të MTPT-së** – kërkoi nga Komisioni që ky ligj të shtyhet për një afat 7-ditor, për t'i paraqitur vërejtjet e veta edhe MTPT-ja.

Pas diskutimeve të gjëra, Komisioni e nxori këtë

### **Përfundim**

- a) Shtyhet - vazhdohet rishqyrtimi i Ligjit për rrugët nr. 2003/ 11, për një afat 7-ditor, me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të ekspertizës së disa fakteve për riamendamentimin e Ligjit;
- b) Zef Morina caktohet raportues për procedurën e riamendamentimit të këtij ligji;
- c) Autorizohet administrata që ta bëjë harmonizimin e preambulës dhe të dispozitës për hyrje në fuqi të Ligjit, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

### **III/c) Ligji nr. 03/L-027 për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);**

**Kryetarja** – ia dha fjalën përfaqësuesit të Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë (në vijim MTI-së) për t'i paraqitur vërejtjet e tyre.

**Hysen Sogojeva - shef i Divizionit të Hotelerisë në MTI** – i komentoi disa pika të Ligjit, pikërisht të nenit që e përcakton ATK-ën (Administrata Tatimore e Kosovës), për mbledhjen e taksave që derivojnë nga ky ligj, mirëpo theksoi se do t'i paraqesë me shkrim vërejtjet e MTI-së për këtë çështje, nëse shtyhet shqyrtimi i Ligjit.

**Haki Shatri** – e mbrojti idenë e nenit përkatës, duke shtuar se kjo kompetencë e mbledhjes së taksave i ka takuar gjithënjë ATK-së, pasi kjo ndërhyrje e propozuar do të shkaktonte kolizion.

Pas diskutimeve të gjëra, Komisioni e nxori këtë

### **Përfundim**

- a) Shtyhet - vazhdohet rishqyrtimi i Ligjit nr. 03/L-027 për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike m qëllim të mbledhjes së informatave për amendamentimin e Ligjit;
- b) Haki Shatri caktohet raportues për procedurën e amendamentimit të Ligjit;
- c) Autorizohet administrata që ta bëjë harmonizimin e preambulës dhe të dispozitës për hyrje në fuqi të Ligjit, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

### **IV. Miratimi i listës së kandidatëve për Komisionin e konkurrencës;**

**Kryetarja** – kërkoi nga Komisioni të miratohet lista prej 5 (pesë) anëtarëve për Komisionin e konkurrencës, të propozuar nga Komisioni intervistues i Komisionit për ETIETT.

**Fatmir Rexhepi** – theksoi se të gjithë kandidatët i kanë plotësuar kushtet. Prej tyre janë përzgjedhur pesë kandidatë, por për shkak se Komisioni intervistues nuk ka qenë në përberje të plotë, pra vetëm me tre anëtarë, si dhe për arsye të tjera personale, tërhiqem nga ky komision dhe e tërheq edhe përcaktimin tim për kandidatët e përzgjedhur. Tani propozoj që Komisioni të përcaktohet për alternativën për të njejtin kandidat ose të bejë përzgjedhje tjetër.

**Berim Ramosaj - anëtar i komisionit intervistues** – tha se ka munguar në takimin e Komisionit për shkaqe objektive, por e mbështet vendimin e Komisionit intervistues.

**Safete Hadergjonaj** – kërkoi që për shkak të mungesës së transparencës, si dhe të mos përzgjedhjes së kandidatëve prej më të mirëve, të mos votohen 5 (pesë) kandidatët e përzgjedhur nga Komisioni intervistues, por të bëhet rizgjedhje e drejtëpërdrejtë nga Kuvendi.

**Sala Berisha – Shala** – duke e fajësuar ligjin për procedurën e sanksionuar, tha se do duhej të ndryshohej ky ligj dhe të autorizohet Qeveria për zgjedhjen e këtij komisioni.

Pas diskutimeve të gjera, Komisioni e nxori këtë

### **Përfundim**

a) Për shkak se nuk u arrit koncesuesi, kjo çështje u shty për një afat të pacaktuar;

### **V. Të ndryshme**

**V/a) Kryetarja informoi Komisionin për arritjen e Projektligjit për masat Antidamping, duke kërkuar ta caktojë një raportues me dy ndihmës për ta përgatitur shqyrtimin në parim, pastaj edhe amendamentimin e Ligjit.**

Pas diskutimeve të gjera, Komisioni e nxori këtë

### **Përfundim**

a) Berim Ramosaj caktohet raportues, kurse Et'hem Çeku dhe Myzejene Selmani caktohen ndihmës për shqyrtimin e Projektligjit për masat antidamping Nr.L-097/1, si për shqyrtim në parim ashtu edhe për amendamentim;

**V/b) Kryetarja ua përkujtoi të pranishmëve se duhet të aktivizohen veprimet për vazhdimin e mbikqyrjes së zbatimit të Ligjit për rrugët nr.2003/11;**

**Kryetarja** – kërkoj nga z. Morina, kryesues i grupit raportues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për rrugët nr.2003/11 që të raportojë për shkallën e realizimit, si dhe për veprimet që duhet të ndërmerren për ta vazhduar dhe për ta përfunduar mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji sipas programit.

**Zef Morina** – u shpreh së është i zhgënjyer nga mosangazhimi i duhur i shumë anëtarëve të caktuar në këtë grup pune, si dhe të anëtarëve të tjerë të Komisionit për monitorimin e zbatimit të Ligjit për rrugët. Ai paralajmëroi se në qoftë se nuk shtohet angazhimi në këtë projekt, nisma për këtë veprim duhet të ndërpritet.

**Safete Hadergjonaj** - duke mos u pajtuar me propozimin për ndërprerjen e monitorimit të zbatimit të Ligjit për rrugët me konkluzionin se kjo është detyrë e Komisionit, shprehu gatishmërinë të marrë pjesë në këtë grup pune.

**Kaqusha Jashari** – theksoi se mospjesëmarrja në aktivitetet përkatëse u bë për shkak të rrethanave objektive – familjare, por tani e tutje është e gatshme ta japë kontributin e saj.

Pas diskutimeve të gjera, Komisioni e nxori këtë

### **Përfundim**

- a) Të intensifikohet puna e Grupit të punës, në krye me Zef Morinën, për mbikqëyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët nr. 2003/11, që sa më parë të hartohet raporti me rekomandime për seancë plenare;

Në vazhdim kryetarja informoi se tani Komisionit i është ofruar:

**V/c) Projekti i OSBE-së për fushatën publike të informimit për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit;**

**Kryetarja** – i'a dha fjalën përfaqësuesit të OSBE-së, për ta paraqitur këtë projektin.

**Artan Canhasi (OSBE)** – E shpjegoi në pika të shkurtra qëllimin e Projektit, që do të jetë në formë fushate nëpërmjet videospoteve televizive. Po ashtu z. Canhasi, kërkoi nga Komisioni që të kontaktoi me RTK-ën për transmetimin e fushatave dhe aktiviteteve tjera pa paqes pasi që RTK-ja është institucion buxhetor.

Pas diskutimeve të gjera, Komisioni e nxori këtë:

**Përfundim**

- a) Mbështetet Projekti i OSBE-së për fushatën publike të informimit për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit;
- b) Caktohet grupi i punës për këtë projekt me këtë përbërje: Myzejene Selmani - kryesuese, Berim Ramosaj dhe Sala Berisha – Shala;

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani